

THIRRJE PËR TRAJNERË!



Instituti Demokratik Amerikan për Çështje Ndërkombëtare (NDI Albania) në bashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, (KQZ) dhe me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Tiranë, është duke kërkuar trajnerë të kualifikuar për të kryer trajnime për subjektet zgjedhore në lidhje me kuadrin ligjor që rregullon financimin e partive politike dhe detyrimin për raportim pranë KQZ-së.

Informacion i përgjithshëm

Në kuadrin e akteve të reja nënligjore ligjore të miratuara nga KQZ-ja për zgjedhjet e ardhshme lokale, partitë politike do të kenë detyrimin për të përfshirë në raportet e tyre financiare pranë KQZ së, edhe të ardhurat dhe shpenzimet e kryera nga kandidatët për kryetarë bashkie për zgjedhjet lokale. Për të ndihmuar subjektet zgjedhore që të raportojnë në përputhje me detyrimet ligjore, NDI do të ofrojë mbështetje për KQZ-në për të trajnuar stafin financiar të subjekteve zgjedhore nga degët e partive dhe vetë kandidatët.

Qëllimi i trajnimeve

Trajnerët e përzgjedhur fillimisht do t'i nënshtrohen një programi Trajnimi për Trajnerë, për t'u mundësuar atyre të pajisen me njohuritë e nevojshme për të zhvilluar pastaj trajnimet për subjektet zgjedhore në lidhje me kuadrin ligjor që rregullon financimin e partive politike dhe raportimin e subjekteve zgjedhore, përfshirë atë të kandidatëve. Trajnerët e përzgjedhur do të kenë të gjithë mbështetjen logjistike dhe organizative nga ana e KQZ-se dhe NDI. Datat e angazhimit për të gjithë programin, përfshirë Trajnimin për Trajnerë dhe trajnimet në rajone, parashikohen afërsisht 4 deri 5 ditë. Trajnerët do të kontraktohen në bazë të kontratës së shërbimeve individuale dhe shpërblimi financiar do të përcaktohet pas procesit të përzgjedhjes.

Kualifikimet e kërkuesve

- Diplomë universiteti mundësisht në degën financë/ekonomi, juridik apo në fusha të tjera të ngjashme;
- Minimum dy vjet përvojë në profesionet përkatëse;
- Aftësi për të vepruar në mënyrë profesionale dhe për të ofruar trajnime interaktive për audiencën e synuar;
- Aftësi të mira komunikimi dhe aftësi për t'iu përgjigjur pyetjeve që mund të ngrihen gjatë trajnimit;

Kriteret/Profili i trajnerëve

- Individë nga shoqëria civile ose të tjerë të angazhuar më parë me zgjedhje ose të përfshirë në monitorimin e zgjedhjeve;
- Kontabilistë të certifikuar.
- Të mos jetë anëtar/kandidat në zgjedhje i ndonjë partie politike.
- Të ketë mundësi udhëtimi jashtë Tirane dhe të punojë në fundjavë.

Procesi i aplikimit

Individët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

- Një CV të hollësishme;
- Një letër motivuese që tregon se si eksperiencia e punës apo formimi profesional janë të lidhura me kriteret e mësipërme
- Një letër reference ose dy kontakte të cilët do të ishin të gatshëm të japin një referencë.

Ju lutemi dërgoni aplikimin tuaj me e-mail tek: mkamolli@ndi.org

Afati për paraqitjen e dokumenteve të kërkuara është 2 Maj, 2019. Aplikimet do të shqyrtohen nga një komision përzgjedhës i përbërë nga NDI dhe KQZ. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për një intervistë.